



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1161_06_14**;
- Ankesa e konsumatorit e datës 24.07.2014.

në seancën e mbajtur më datë 29 gusht 2014, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Q. Sh me shifër DPR 41250 nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1161_06_14 i datës 26.06.2014.

Arsyetim

Me datë 05.10.2013 Departamenti i Faturimit në KEDS i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën shtator 2013 në vlerë financiare 959.91€. Pas kësaj fature të energjisë elektrike konsumatori me datë 10.10.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEDS duke kundërshtuar faturën e periudhës shtator 2013 për shkak të leximit jo korrekt.

Punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse me datë 28.10.2013 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 08195270: TL=030474kWh (tarifa e lartë) dhe TU=011953 kWh (tarifa e ulët).

Me datë 01.11.2013 Departamenti për Konsumator në KEDS i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij. Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEDS-it ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas parashtrimit të ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 26.06.2014 ka nxjerr vendim duke e aprovuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEDS-i që të: i) shkarkoj konsumatorin nga fatura e energjisë elektrike 09130DPR-41250 të datës 05.10.2013 për muajin 09/2013 në vlerë prej 959.91€; dhe ii) ngarkoj/faturoj konsumatorin me shifër DPR – 41250 për muajin 09/2013 me shpenzimin e njëjtë me vitin 09/2012 në vlerë prej 43.71€ (TL=550 kWh dhe TU=252 kWh); iii). diferencën e shpenzimit të energjisë elektrike të muajit 09/2013 dhe të shpenzimit të pikës 2 (TL=10825 kWh dhe TU=140 kWh), ta shpërndaj proporcionalisht nga periudha 01/2007 – 12/2008, dhe nga llogaritja del se faturimi do të duhej të ishte 720.88€; dhe iv). korrigjoj (shkarkoj) konsumatorin me shifër DPR – 41250 në vlerë prej 195.32€ nga borxhi i përgjithshëm i energjisë



elektrike; dhe v). ofroj konsumatorit me shifër DPR – 41250 një marrëveshje pagese për 24 muaj për vlerën prej 764.59€, ku kësti mujor do të jetë 31.86€.

Baza e kundërshtimit të konsumatorit se vendimi i DMK në ZRRE nuk ka marrë për bazë të gjitha rrethanat e paraqitura në ankesën e konsumatorit. Konsumatori në ankesë ka theksuar se deklaroi me përgjegjësi të plotë se asnjëherë më parë nuk ka pasur një shpenzim të tillë dhe ma pajisjet të cilat i ka përdorur nuk ka mundur ta bëjë një shpenzim të tillë dhe se këtë vërtetohet edhe faturat e muajit shtator pasi që energjia elektrik nuk është përdorur për ngrohje, por është përdorur vetëm për ndriçim dhe pajisje të amvisërisë. Andaj edhe rezultoi se KEDS me këtë rast ka gabuar në llogaritjen e leximit dhe paraqitjes së shpenzimit. Në fund të ankesës konsumatori thekson se kërkon nga Bordi që të anulon vendimin e DMK-së dhe të bëhet ekspertiza me qëllim të vërtetimit të saktë dhe të drejtë të gjendjes.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29 gusht 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, dhe pas vlerësimit të gjitha këtyre shkresave ka vërejtur se DMK, ka vepruar konform dispozitave ligjore në fuqi me rastin e marrjes së këtij vendimi. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se sipas procesverbalit të kontrollës nr. 0509387 të datës 28.10.2013 gjendja e evidentuar e njehsorit elektrik nr. 08195270 nga punëtorët e autorizuar të kontrollës në procesverbal përputhet me gjendjen e evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike të konsumatorit. Bordi po ashtu ka vërejtur se KEDS-i përmes shkresës zyrtare të dërguar ZRRE-së ka konfirmuar se në fshatin Barilevë ka pasur gabime gjatë leximit të shpenzimit të energjisë elektrike e të regjistruar në njehsorët elektrik në muajt e mëparshëm dhe kjo pastaj ka rezultuar me shpenzim të lartë të atyre muajve kontestues.

Sa i përket pikës së konsumatorit se asnjëherë më parë nuk ka pasur shpenzim të tillë aq të lartë, Bordi i ZRRE-së thekson se gjatë analizës së bërë shpenzimeve të energjisë elektrike ka vërejtur se një shpenzim të tillë si ajo e evidentuar në muajin 09/2013 nuk është evidentuar më herët dhe konstaton shpenzimi i energjisë elektrike i muajit 09/2013 nuk është shpenzim real mujor, por kemi grumbullim të shpenzimit të muajve të mëparshëm, dhe se vështirë se mund të përcaktohet saktë se kur filluar ky mos lexim i rregullt nga ana e ndërmarrjes së energjisë. Por Bordi gjatë analizës së shpenzimeve të të energjisë elektrike ka vërejtur se gjatë viteve 2007 dhe 2008 kemi një rënie të shpenzimit të energjisë elektrike në krahasim me shpenzimet e viteve tjera, dhe ajo rënie e shpenzimit ka qenë mjaft e dukshme. Po ashtu është vërejtur se mesatarja e përgjithshme mujore e shpenzimit të energjisë elektrike pas periudhës kontestuese ka pësuar ngritje të shpenzimit të energjisë elektrike në krahasim me shpenzimin e energjisë para periudhës kontestuese, dhe atë prej 20%. Bordi i ZRRE-së duke pasur parasysh se shpenzimi i muajit 09/2013 nuk është shpenzim real mujor dhe se ai shpenzim paraqet grumbullim të shpenzimeve konstaton se llogaritjet e bëra nga DMK në vendimin e tyre për korrigjim të konsumatorit janë të sakta.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.08.2014 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1161_06_14, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.



- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimt të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar